

LIGJ
Nr.7565, datë 20.5.1992

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7523, DATË 6.11.1991 "PËR NDËRMARRJET
SHTETËRORE"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7523, datë 6.11.1991 "Për ndërmarrjet shtetërore", bëhen këto ndryshime:

- Neni 24, paragrafi i parë i nenit 27, neni 28, pika "b" e nenit 34, pika "d" e nenit 44, shfuqizohen.

- Gërma "ç" e nenit 44 ndryshohet si vijon:

" Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e këshillit drejtues ".

- Gërma "e" e nenit 44 ndryshohet si vijon:

" Miraton llogaritë vjetore ".

Neni 2

Deri në miratimin e ligjit të ri "Për ndërmarrjet shtetërore dhe ligjit "Për pagat e punës" niveli i pagës bazë për punëtorët e nëpunësit e ndërmarrjeve shtetërore mbetet ai që është marrë në muajin prill 1992.

Neni 3

Deri në daljen e ligjit të ri "Për ndërmarrjet shtetërore" veprimtaria në ndërmarrjet shtetërore organizohet, drejtohet, dhe përfaqësohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet:

a) Për ndërmarrjet nacionale nga Ministria ose institucioni tjetër qendror.

b) Për ndërmarrjet lokale nga komitetet ekzekutive të rretheve.

Neni 4

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të paraqesë në Kuvendin Popullor projektligjin "Për ndërmarrjet shtetërore" dhe projektligjin "Për pagat e punës", brenda datës 10 qershor 1992.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

+

Shpallur me dekretin nr.189, datë 21.5.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha